



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300096/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandim për inspektimin e kryer në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë në Tiranë.*

Drejtuar : **Drejtues i Parë Tonin VOCAJ**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Për dijeni: **Drejtues Madhor Mehmet RRUMBULLAKU**
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

I nderuar z. Vocaj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe në nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në "Bllokun e Sigurisë" dhe në Ambientin e Shoqërimit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP), Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 20 dhe 27.01.2023, sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, MKPT mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të

migrantëve të parregullt, qendrat ku mbahe shtetasit e huaj të privuar nga liria dhe azilkërkuesit, si dhe institucionet psiqiatrike e shtëpitë e të moshuarve.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu në këtë inspektim, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde të punës: *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e inspektimit të MKPT-së, grupi i inspektimit u takua me zv/Drejtorin për sigurinë publike pranë DVP-së Tiranë z.Luigj Vathi, shefin e seksionit për rendin z.Asllan Shyti dhe shefin e sigurisë në “Bllokun e ri të Sigurisë” z.Blerim Shtëmbari, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e vizitës së inspektimit të MKPT-së në mjediset ku mbahen personat e privuar nga liria, në DVP Tiranë.

Në takim, grupi i inspektimit të MKPT-së u informua mbi masat e marra nga strukturat përgjegjëse në DVP Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm¹, për kushtet infrastrukurore të krijuara në mjediset e reja pas vënies në funksionim të “Bllokut të ri të Sigurisë”, si dhe përshtatjen e ish-dhomave të sigurisë që ndodheshin pranë kësaj drejtorie, me destinacion kthimin e tyre në dhoma shoqërimi të personit.

Në vijim, grupi i punës inspektoi ambientet në “Bllokun e ri të Sigurisë” (që ndodhet pranë Komisarariatit të Policisë nr.3) ku mbahen dhe trajtohen të arrestuarit/ndaluarit nga komisarariatet e policisë Tiranë dhe personat me masë sigurie “arrest me burg” të DVP-së Elbasan, ambientet e shoqërimit në DVP Tiranë, zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, si dhe u njoh e

¹ Shkresë nr.K4/I2-2 prot., datë 01.04.2022 “Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë në Tiranë”.

administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e privuar nga liria.

Nisur nga informacioni i drejtuesve të policisë dhe inspektimi i kryer në mjediset e sigurisë dhe të shoqërimit në këtë drejtori, rezultoi se, respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria dhe kushtet infrastrukturore të ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit, në përgjithësi ishin sipas normave dhe parametrave teknikë të parashikuara në procedurat standarde, që garantojnë sigurinë dhe trajtimin e këtyre personave, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Nga verifikimi i rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se, **“Blloku i ri i Sigurisë” kishte përfunduar ndërtimin dhe kishte filluar funksionimin e tij**, që prej datës 22.10.2022. Kushtet e krijuara në këtë godinë, plotësonin në masën më të madhe kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare për ndërtimin e ambientit të sigurisë.

Gjithashtu, dhomat e sigurisë që ndodheshin në DVP Tiranë, **ishin përshtatur dhe adoptuar në dhoma shoqërimi**, të kompletuara me orenditë e nevojshme, sipas kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në procedurën standarde për këtë qëllim.

Theksojmë se, gjatë kryerjes së vizitës inspektuese në DVP Tiranë, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të të gjitha niveleve, u treguan bashkëpunues dhe transparentë me grupin e inspektimit të MKPT-së pranë Avokatit të Popullit.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre.

Ambienti i ri i shoqërimit në DVP Tiranë, ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhër nr.938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Sikurse u përmend edhe më lart, dhomat e sigurisë të kësaj drejtorie ishin kthyer në 4 (katër) dhoma shoqërimi, nga të cilat 2 (dy) për të rriturit, 1 (një) për gratë dhe 1 (një) për të mitur. Sipërfaqja dhe hapsira e dhomave të shoqërimit ishte e bollshme. Ato ishin të kompletuara me karrige të fiksuara në dysheme, për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar.

Dritaret e dhomave të shoqërimit kishin përmasa të tilla, që mundësonin ajrim dhe ndriçim natyral të plotë. Në pjesën e jashtme, ato ishin të siguruara me rrjetë hekuri, me qëllim ruajtjen fizike të personave të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik dhe si burim rezervë, kishin gjenerator në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Në ambientin e shoqërimit, ndodhej zyra e oficerit të informacionit, dy dhoma të cilat ishin në projekt për tu kthyer në dhomë për njohjen dhe identifikimin e personit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale dhe një dhomë për intervistimin e personave të shoqëruar, por ato ende nuk ishin përshtatur si të tilla.

Në disa nga dhomat, u konstatuan ende skara hekuri të montuara në muret e brendshme, të mbetura nga koha që ato dhoma ishin me destinacion si dhoma sigurie. Skarat e hekurit ndodheshin gjithashtu edhe në korridorin e ambientit të shoqërimit. Prezenca e skarave të hekurit në ambientin e shoqërimit, nga ana vizive përbën për personat e shoqëruar formë presioni psikologjik, por dhe si premisë për mundësinë e kryerjes së vetëvrasjeve të personave të shoqëruar apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në konceptin juridik, **“Shoqërimi” është veprimi administrativ**, me karakter detyrues dhe shtrëngues (qoftë edhe forcërisht), që kryhet nga punonjësi i policisë për dërgimin e shtetasit në ambientet e policisë ose në institucionet e tjera, sipas përcaktimeve dhe procedurave të parashikuara me ligj e akte nënligjore.

Ekzistenca e një elementi shtrëngues në ushtrimin e kompetencave policore të shoqërimit për verifikim e të ushtrimit të kontrollit tregon një heqje lirie të personit, pavarësisht qëllimit të shoqërimit dhe se sa e shkurtër është koha e qëndrimit në mjediset e policisë të shtetasve. Në këto kushte, ambientet e shoqërimit në polici duhet të jenë të ndërtuara në proporcion të drejtë me veprimin administrativ të kryer nga punonjësit e policisë në rastin e shoqërimit të personit. Konkretisht, në nenin 109 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: *“Personi i shoqëruar **nuk** trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë”*.

Sa më lart, në vlerësimin e Avokatit të Popullit, prezenca e skarave të hekurit në mjedisin dhe dhomat e shoqërimit, përbën trajtim jo njerëzor dhe jo dinjitoz të personave që qëndrojnë në këto dhoma, ndaj ato duhet të hiqen sa më parë nga këto ambiente.

Ambienti i ri i shoqërimit kishte dhoma të lira, por ende asnjëra prej tyre nuk ishte përshtatur në dhomë për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë. Dhomat e shoqërimit, ishin të kompletuara me karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar, ndërkohë mungonin tavolinat e punës për specialistët e policisë. Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, marrja në pyetje e personit vijon të kryhet në zyrat e punës së specialistëve të policisë.

Kjo praktikë, bie ndesh me kërkesat e parashikuara në procedurën standarde në lidhje me kushtet e mbajtjes dhe sigurisë të personave të shoqëruar, ku thuhet shprehimisht se: *“Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura **pajisje e orendi pune për specialistët***

e ndihmës specialistët e policisë si; tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme”².

Gjithashtu, intervistimi dhe marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e kësaj drejtorie, kryhet ende në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në procedurën standarde³.

Nga kqyrja e dokumentacioni për të miturit në konflikt me ligjin, u verifikua se, marrja në pyetje e tyre kryhej në prezencë të psikologut të DVP Tiranë, kujdestarit ligjor të të miturit dhe të avokatit mbrojtës.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodheshin dy tualete për mbajtjen e higjienës personale dhe të ambienteve, të ndara më vehte për gra dhe për burra. Ato ishin të pajisura me nyje hidrosanitare dhe furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje nga rrjeti i UK Tiranë.

Në ambientin e shoqërimit, u evidentua se ishin të instaluar kamerat e sigurisë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe hyrjes për në dhomat e shoqërimit, të cilat monitorojnë veprimet e punonjësve të policisë gjatë kryerjes së procedurave me personat e shoqëruar brenda mjediseve të policisë.

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla, që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë, me përjashtim të prezencës së skarave të hekurit.

Në momentin e inspektimit, në mjedisin e shoqërimit nuk ndodhej asnjë person në cilësinë e të shoqëruarit. Ndërsa, për periudhën një vjeçare në regjistrin e të shoqëruarve ishin evidentuar të dhënat për 2484 persona, nga të cilët 2318 meshkuj të rritur, 154 gra dhe 12 të mitur.

“Blloku i Sigurisë”, trajtimi i të arrestuarve/ndaluarve dhe kushtet e tyre

“Blloku i Sigurisë” në Tiranë, është një investim i ri ku mbahen dhe sigurohen personat e arrestuar/ndaluar nga të gjitha komisariatet e policisë në varësi të DVP-së Tiranë. Gjithashtu, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në këto ambiente sigurohen edhe personat me masë “arrest me burg”, të DVP-së Elbasan.

² Pika 4, kreu VII “Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar”.

³ Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.....k) **Të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë**”.

Investimi në “Bllokun e Sigurisë” u krye me fondet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në vitet 2019-2022, si domosdoshmëri për zgjerimin e kapaciteteve mbajtëse, akomoduese dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në mjediset e DVP-së Tiranë, si dhe në kuadër të angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria e RSH në zbatim të rekomandimeve të KPT-së (CPT) në vizitën inspektuese të zhvilluar në Shqipëri në vitin 2018⁴. Pas shumë përpjekjeve dhe angazhimeve të institucioneve shtetërore, duke përfshirë edhe institucionin e Avokatit të Popullit, hapja e bllokut të sigurisë u krye në datë 22.10.2022.

Pavarësisht vonesave, disa të pajustificuara, në kryerjen e këtij investimi, Avokati i Popullit ka vlerësuar pozitivisht ngritjen dhe ndërtimin e një blloku sigurie të përqëndruar për të gjitha komisariatet e policisë në varësi të DVP Tiranë, ka mbështetur ecurinë e projektit në të gjitha fazat e ndërtimit të tij, si dhe ka inkurajuar përfundimin sa më parë të punimeve, për vënien në funksionim të këtyre ambienteve, të cilat rrisin cilësinë e jetës dhe të trajtimit të personave të arrestuar/ndaluar.

“Blloku i Sigurisë” është i ndërtuar në masën më të madhe sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodheshin 30 persona në cilësinë e të arrestuarit/ndaluarit, nga të cilët 28 burra në moshë madhore, 1 grua dhe 1 i mitur. Në radhët e personave të arrestuar/ndaluar ndodheshin dhe 4 shtetas të huaj, prej të cilëve 2 me origjinë nga Turqia, 1 me origjinë nga Kina dhe 1 me origjinë nga Kosova.

Nga verifikimi i regjistrit të të dhënave të personave të arrestuar/ndaluar u evidentua se, për periudhën 22 tetor 2022 deri në 20 janar 2023 ishin akomoduar në bllokun e sigurisë 1976 persona, nga të cilët 76 persona me masë sigurie “arrest me burg” të DVP Elbasan, 37 gra dhe 11 të mitur. Nisur nga numri total i personave të arrestuar/ndaluar, mesatarja ditore e të akomoduarve në këto dhoma ishte 22 persona, pra brenda kapacitetit fizik dhe numrit të shtretërve të bllokut të sigurisë.

Godina e bllokut të sigurisë është një ndërtesë 5 katëshe, me një kat nëntokë për parkimin e automjeteve të policisë. Mjedisi i sigurisë kishte pothuajse të njëjtën konfiguracion të ambienteve në secilin nga katet me:

- 16 dhoma sigurie
- një dhomë për përgjegjesin e dhomave të sigurisë
- një dhomë për paraqitje për njohje
- një dhomë për mbajtjen e sendeve personale
- një dhomë për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar

⁴Raporti i CPT-2019, Faqe 8 link: <https://rm.coe.int/16809cb571>

- një dhomë për kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku i DVP-së Tiranë.
- dhoma e daktiloskopisë (ndodhej në katin e 4)
- 2 tualete të ndara më vehte për burra dhe gra
- dhoma e dusheve me nga 3 poste për larjen e trupit

Për komunikimin nga njëri kat në tjetrin shërbente ashensori dhe shkallët, ndërkohë për arsye sigurie midis kateve ishin vendosur edhe skara hekuri. Në katin e parë të godinës ndodheshin ambientet e zyrave të punës së administratës, një sallë për mbledhje, si dhe tualeti për personat me aftësi të kufizuar.

Blloku i ri i Sigurisë ka në total 63 dhoma sigurie për akomodimin e personave të arrestuar apo të ndaluar, nga të cilat 58 dhoma me destinacion për burra në moshë madhore, 3 dhoma për gra dhe 2 dhoma për të mitur. Dhomat për të arrestuarit/ndaluarit gra dhe të mitur ndodheshin në katin e 2-të të godinës. Kapaciteti fizik dhe pajisja me shtretër ishte për mbajtjen dhe akomodimin e 66 personave të arrestuar/ndaluar, nga një person për çdo dhomë, në kushte të përshtatshme e kryesisht brenda standardit.

Ndërtimi i dhomave ishte sipas normave dhe parametrave të ndërtimit të dhomave të sigurisë, konkretisht 60 dhoma për një person dhe 3 dhoma për dy persona. Sipërfaqja dhe hapësira e dhomave të sigurisë ishin me përmasa të mjaftueshme për mbajtjen dhe trajtimin e 1-2 personave⁵.

Dhomat e sigurisë janë të organizuara në dy ambiente, në ambient qëndrimi dhe në paradhomë, të ndara me njëra tjetrën me një skarë hekuri dhe derë që mbyllet me çelës. Skara e hekurit, në lartësinë 60 cm nga dyshemeja, kishte një shufër hekuri të vendosur horizontalisht që mbante të fiksuar shufrat e hekurit të vendosura vertikalisht, sipas kërkesave të parashikuara në procedurën standarde.

Në ambientin e qëndrimit janë të vendosura pajisjet dhe orenditë e nevojshme si krevati (kompletuar me dyshekë, jastëk dhe batanie) i ndërtuar me elementë hekuri, i cili është i fiksuar me mentesha e vida në dysheme; paisja e VC-së pa mbajtëse e fiksuar në mënyrë të paçmontueshme e vendosur në pozicion që nuk pengon pamjen/vëzhgimin e punonjësit të policisë nga sporteli i derës së dhomës; buton me zile/sinjali i montuar në mur për kontakt me punonjësin e shërbimit në rast nevojë. Në dhomën e qëndrimit nuk kishte të instaluar pajisje ndriçimi dhe asnjë instalim tjetër elektrik, hidraulik apo ngrohje, tuba apo hekura të dala jashtë murit apo dyshemesë, të cilat cenojnë elementët e sigurisë për personat e arrestuar/ndaluar. Ndriçimi i dhomës bëhet nëpërmjet pajisjeve elektrike të vendosur në paradhomë.

Në ambientin e paradhomës janë të vendosura dhe të instaluara çezma me lavaman së bashku me rubinetin e ujit; depozitë uji për VC-në; pajisje elektrike për ndriçim të

⁵ Normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë së dhomave për një të arrestuar/ndaluar janë: sipërfaqe të përgjithshme jo më pak se 10 metër katror, e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Lartësia e këtyre ambienteve është jo më pak se 2.5 m.

paradhomës e dhomës së qëndrimit dhe pajisje për ngrohje gjate dimrit. Të gjitha pajisjet e mësipërme ishin të vendosura në një largësi të tillë nga zgara e hekurit që ndan ambientin e qëndrimit me paradhomën, për të mos lejuar prekjen me dorë nga i ndaluari apo arrestuari nga dhoma.

Ngrohja e ambienteve të punës të punonjësve të policisë, dhomave të sigurisë dhe korridoreve të secilit kat, sigurohej nga një sistem qëndror chiller dhe ishte në kushte normale.

Krijimi i “Bllokut të Sigurisë”, mundësoi lirin e ambienteve në komisaritet e policisë në Tiranë, për ti kthyer ato në mjedise shoqërimi. Në këto kushte, institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar në inspektimin e vitit të kaluar, kryerjen e një studimi konkret për nevojën e rritjes së kapaciteteve të ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në kryeqytet, si dhe pajisjen e tyre me orenditë e nevojshme, për të lehtësuar punën e specialistëve të policisë, qëndrimin ulur të personave apo dhe akomodimin e tyre, sipas standardeve të kërkuara ndërkombëtare.

Por, nga inspektimi periodik i MKPT-së në muajin janar 2023 në Drejtorinë dhe komisaritet e policisë në Tiranë, u konstatua se në këto mjedise nuk ishin kryer investimet e nevojshme (me përjashtim të Komisaritit nr.1 dhe 5) për ndryshimin e destinacionit të dhomave të sigurisë në dhoma shoqërimi, si dhe kishte ende një prezencë të madhe të skarave të hekurit, të cilat duhet të hiqen në mënyrë të menjëhershme nga ambientet e reja të shoqërimit.

Grupi i inspektimit, në bazë të metodologjisë të inspektimit, zhvilloi intervista konfidenciale me personat e arrestuar/ndaluar që ndodheshin në bllokun e sigurisë. Nga intervistat, rezultoi se një nga personat e ndaluar nga punonjësit e policisë për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë të gjykatës, kishte 9 ditë qëndrim në këtë institucion dhe ende nuk ishte transferuar në një nga IEVP-të, ndërkohë që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit midis institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me nr.897/3 datë 04.03.2019 dhe nr.2194 datë 05.03.2019 “*Për kalimin në një IEVP të të ndaluarit/arrestuarit me masë sigurie paraburgim dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë*”, transferimi i këtyre personave duhet të kryhet brenda 24 orëve nga koha e paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit⁶.

Kjo problematikë, në DVP dhe komisaritet e policisë në Tiranë, është e përsëritur dhe ende vijon të mbetet e pazgjidhur në vite, duke evidentuar një shkelje të rëndë të të drejtave që gëzojnë personat e dënuar me vendime të formës së prerë nga gjykata, të cilët duhet të vuajnë dënimin në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale dhe jo në dhomat e sigurisë të policisë së shtetit. Por, sikurse rezultoi nga inspektimi, kjo marrëveshje nuk po

⁶ Përgjigje e Qeverisë Shqiptare në zbatim të rekomandimeve të KPT-së(CPT) në vizitën inspektuese të zhvilluar në vitin 2018. Raporti përfundimtarë i CPT-së dhe përgjigjet e Qeverisë Shqiptare janë botuar në vitin 2019. Shih link: Raporti i CPT-2019 <https://rm.coe.int/16809cb571>

zbatohet në mënyrë efektive nga institucionet e përfshira në këtë dokument, si dhe në përputhje me qëllimin e saj, për t'i dhënë fund praktikës së mbajtjes në polici të personave me masë sigurie "arrest me burg" dhe të dënuarve me burgim me vendim të formës së prerë.

Nga intervistimi, u evidentuan gjithashtu dy persona të cilët **nuk** ishin të pajisur me setin e dokumenteve që plotësohen nga OPGJ-të, menjëherë pas komunikimit të arrestuarit/ndaluarit të masës të sigurisë "arrest me burg", sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar dhe procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre". Në këto dokumente, përcaktohet qartësisht se, pranimi i të arrestuarve/ndaluarve në ambientet e dhomave të sigurisë, bëhet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, kundrejt dokumentacionit të mëposhtëm: "Për të arrestuarin/ndaluarin:

- a) *Procesverbalin e arrestimit në flagrancë apo urdhrin e ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore, prokurori, urdhri i ekzekutimit të prokurorit, si dhe kopje të vendimit gjyqësor.*
- b) *Procesverbalin e kontrollit personal së bashku me sendet personale të cilat janë konstatuar dhe gjetur gjatë kontrollit.*
- c) *Letra me të drejtat që gëzojnë personat e arrestuar/ndaluar".*

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, këto raste ndonëse sporadike, krahas shkeljeve të kërkesave ligjore të lartpërmendura nga OPGJ-të në DVP Tiranë, njëherësh kjo praktikë përbën shkelje të të drejtave të personave të arrestuar në lidhje me informimin e këtyre personave që në momentin e hyrjes në mjediset e policisë, me arsyet e arrestimit ose ndalimit tyre, sipas edhe nenit 34/b të K.Pr.P.

Një problematikë tjetër e evidentuar nga intervistat me personat e arrestuar/ndaluar gjatë inspektimit, kishte të bënte me ankesat, për **mungesën e avokatit mbrojtës dhe të përkthyesit (shtetasit e huaj)**, në momentin e marrjes në pyetje dhe komunikimit të masës së sigurisë "arrest me burg", nga OPGJ-të e DVP-së Tiranë.

E drejta për tu mbrojtur me avokat privat, është një e drejtë e garantuar me ligj dhe mungesa e tij, cënon rëndë parimin kushtetues për një proces të rregullt ligjor. Kjo e drejtë është e parashikuar dhe në nenin 6/3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷. Kjo e drejtë, garantohet njëjloj si për shtetasit shqiptarë ashtu edhe ata të huaj.

⁷ "3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

- a. *të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*
- b. *t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
- c. *të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*

Problematika e mësipërme është konstatuar edhe nga KPT (CPT) gjatë vizitës së fundit inspektuese në Shqipëri në vitin 2018, ku në raportin përfundimtar drejtuar autoriteteve shtetërore ka rekomanduar se: *“Oficerët e policisë duhet të kenë parasysh që të lejojnë të ndaluar/të arrestuarit të kenë qasje tek një avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasin me të dhe të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje) që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të garantojnë në praktikë këtë të drejtë”*⁸.

Nisur nga ky konstatim, i cili duhet theksuar se është evidentuar në inspektimet e mëparshme të zhvilluara nga MKPT-së (në rastin e protestave të zhvilluara në Tiranë) dhe në zbatim të rekomandimit të KPT-së, Avokati i Popullit me shkresë nr.K4/I17-2 prot., datë 08.07.2022 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtorit të DVP-së Tiranë, ka rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme për mos përsëritjen e kësaj situate, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive ligjore ndaj OPGJ-ve që kanë cënuar rëndë të drejtat procedurale ndaj personave të ndaluar dhe të arrestuar, gjatë procesit të marrjes në pyetje të tyre. Pavarësisht sa më sipër, duket se situata vijon të shfaqë problematika.

Në “Bllokun e Sigurisë” ndodheshin 4 dhoma për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar nga OPGJ-të (prokurorët) e çështjes, një dhomë në secilin kat. Dhomat e marrjes në pyetje ishin në kushte komode të pajisura me orëditë e nevojshme si tavolina pune dhe karrige për qëndrimin ulur të punonjësve të policisë dhe personave të arrestuar apo të ndaluar, me këmbë të fiksura në dysheme në mënyrë të palëvizshme. Në secilën dhomë ishin të instaluara kamerat e sigurisë audio-vizive, pamjet e të cilave mbaheshin në vëzhgim gjatë 24 orëve nga punonjësit e policisë në sallën operative dhe afati i ruajtjes ishte 30 ditë. Administrimi i sistemit të kamerave të sigurisë kryhet nga departamenti i IT-së në DPPSH.

Blloku i Sigurisë, kishte 4 dhoma për kryerjen e vizitave mjekësore të mjekut, nga një në secilin kat të ndërtesës. Mjeku dhe ndihmësmjeku, janë në organikë të DVP-së Tiranë. Dhomat e vizitave mjekësore, janë të kompletuara me orëditë e nevojshme si tavolinë pune, raftin për mbajtjen e dokumentacionit dhe të regjistrave të vizitave mjekësore, rafte për mbajtjen e medikamenteve mjekësore të urgjencës, krevat, karrige për qëndrimin ulur të personave, si dhe pajisja për ngrohjen e ambientit.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm i ambienteve në bllokun e sigurisë kryhej nga ujësjellësi i Bashkisë Tiranë, pa ndërprerje gjatë 24 orëve. Në secilin kat, ndodheshin 2 tualete dhe 1 ambient dushi me 3 poste për larjen e trupit. Ambientet e tualeteve dhe të dusheve për larjen e trupit ishin ambiente të ndara më vehte, si dhe të kompletuara me pajisje të reja elektrike, hidraulike, koka dushi dhe hidrosanitare.

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq”.

⁸ <https://rm.coe.int/16809cb571>

Nga intervistat me të arresuarit/ndaluarit, u evidentuan disa ankesa që kishin të bënin me ujin e pijshëm. Sipas punonjësve të policisë, uji nga rrjeti i ujësjellësit është i pijshëm, ndërsa të arrestuarit dhe të ndaluarit kishin vërejtje për cilësinë e ndotur të ujit. Për evitimin e këtij shqetësimi, është e nevojshme vendosja e filtrave qëndror për pastrimin e ujit, duke mundësuar përdorimin e tij nga personat që akomodohen në këto ambiente.

Në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë (që ndodheshin gjithashtu në çdo kat), janë të vendosura pajisjet dhe orenditë e nevojshme (karrige, tavolina dhe rafte), si dhe ishte i montuar telefoni fiks për komunikim të punonjësve të shërbimit me sallën operative në rast nevoje, ndërsa brenda në dhomat e sigurisë janë të instaluar butoni me zile/sinjali për kontaktin e të ndaluar/arrestuarve me punonjës të policisë.

Ambientet e brendshme dhe të jashtme të bllokut të sigurisë, janë të survejuara nga kamerat e sigurisë, të vendosura kryesisht në korridorët e secilit kat, në hapësirat midis kateve dhe në dhomat e marrjes në pyetje.

Ndriçimi në bllokun e sigurisë furnizohej nga rrjeti elektrik, si dhe me një gjenerator, i cili shërbente si burim alternativ rezervë për ndriçim, në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Gjatë inspektimit, në ambientet dhe dhomat e sigurisë, nuk u gjetën sende që shkaktojnë/eksponojnë dhunë psikologjike tek të ndaluarit/arrestuarit.

Kushtet higjieno-sanitare në bllokun e sigurisë ishin të mira, ambientet ishin të lyera dhe të pastra. Pavarësisht kohës që ky mjedis është venë në funksionim, ai kishte nevojë për mirëmbajtje, pasi u konstatuan papastërti dhe koka dushi të dëmtuara.

Disa nga të arrestuarit/ndaluarit që ishin konsumatorë të duhanit, ngritën me shqetësim mungesën e një ambienti ajrimi dhe orari të miratuar të dedikuar me qëllim konsumimin e duhanit.

Mungesa e hapsirës për ajrim e personave të arrestuar/ndaluar, përbën shkelje të së drejtës për të dalë disa orë në ajër të pastër gjatë qëndrimit në institucionet e mbyllura⁹.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, të dhënat për personat e shoqëruar regjistrohen në *“Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”*, i cili ishte i hapur

⁹ *Kreu VII, pika 6 e procedurës standarde për personat e arrestuar/ndaluar ku thuhet se: “Ajrimi kryhet në mjedise të caktuara brenda sistemit të ambienteve të dhomave të sigurisë, në një vend të ndërtuar posaçërisht (dhomat e ajrimit).... Koha e qëndrimit në ajrim është jo më pak se dy orë në ditë.”.*

sipas modelit 1 të përcaktuar në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”¹⁰.

Në momentin e inspektimit u konstatua se, regjistri i të shoqëruarve ishte i plotësuar sipas rubrikave për personat që ndodheshin në cilësinë e të shoqëruarve në mjediset e drejtorisë së policisë. Ai ishte i protokolluar dhe i sekretuar.

Nga këqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar për periudha të ndryshme, rezultoi se rubrikat e tij ishin plotësuar në rregull. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Për personat që ishin të dyshuar për vepra penale, koha e shoqërimit shkonte deri në 12 orë, me qëllim mbledhjen e provave, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Të dhënat për personat e arrestuar/ndaluar, evidentoheshin në regjistrin e miratuar sipas modelit të përcaktuar në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Ky regjistër, mbahej në çdo zyrë përgjegjësi të dhomave të sigurisë që ndodheshin në secilin kat të bllokut të sigurisë dhe ato ishin të plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij dhe ishte i sekretuar.

Nga krahasimi i dy regjistrave, si dhe nga verifikimi i procesverbalit të arrestimit në flagrancë apo urdhri i ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore (prokurori) për personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, u evidentua se koha e arrestimit apo ndalimit të të shoqëruarve përputhej me kohën e shoqërimit të tyre në mjediset e DVP Tiranë.

Grupi i inspektimit të MKPT-së, evidentoi gjatë inspektimit në ambientin e shoqërimit se, personeli që kryente shërbim në këtë ambient, **nuk** kishte të ruajtur kopje të “Formularit të Raportit të Shoqërimit” dhe të “Procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar” (*Lidhja model nr.3*), sipas kërkesave që parashikohen në procedurën standarde për këtë qëllim, ku thuhet se: “*Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit*”¹¹.

Ky konstatim, përbën shkelje të të drejtave, që gëzojnë personat e shoqëruar në mjediset e policisë, pasi punonjësi i shërbimit të informacionit nuk duhet të pranojë dhe nuk duhet të marrë në dorëzim personin e shoqëruar, pa u plotësuar dhe dorëzuar formulari i raportit të shoqërimit nga punonjësit e policisë që kanë kryer shoqërimin e personit.

¹⁰“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, kreu VIII “Procedura të dokumentimit të veprimit të shoqërimit”, pika a.1.2, “Regjistri i evidentimit të personave të shoqëruar”.

¹¹“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, kreu VIII “Procedura të dokumentimit të veprimit të shoqërimit”, pika a.2, “Formulari i Raportit të Shoqërimit”.

Në përfundim të veprimeve të kryera, kur shtetasi lihet i lirë, punonjësi i policisë duhet të plotësojë gjithashtu procesverbalin përkatës në dy kopje, ku një i jepet personit të shoqëruar dhe kopja tjetër pasi grumbullohet nga punonjësi i informacionit, dorëzohet në sekretari/arshivën e institucionit.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë

Në kohën e inspektimit, në ambientin e shoqërimit të DVP-së, Tiranë, nuk ndodhej asnjë person në cilësinë e të shoqëruarve. Ndërsa në bllokun e sigurisë ndodheshin 30 (tridhjetë) persona në cilësinë e personave të arrestuar/ndaluar, nga të cilët 1 (një) grua dhe 1(një) i mitur.

Nga intervistimi i personave të arrestuar/ndaluar, grupi i inspektimit konstatoi se ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në dhomat e sigurisë. Të intervistuarit nuk kishin pretendime për trajtim denigrues, jo human, apo për ushtrim të dhunës fizike e psikologjike ndaj tyre.

Gjendja psikologjike e të miturit të intervistuar ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi për shkak të veprimeve të kundraligjshme të punonjësve të policisë.

Të intervistuarit nuk dëshmuar frikë apo druajtje për të raportuar nëse ishin keqtrajtuar. Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Koha e qëndrimit e të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor dhe ishin në pritje të vleftësimit të masës të sigurisë nga ana e gjykatës sipas procedurës të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale. Ndërsa, një nga personat e ndaluar për shkak të vendimit të formës së prerë të gjykatës, kishte 9 ditë që qëndronte në ambientin e sigurisë, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk kishte kthyer përgjigje shkresës të DVP Tiranë për transferimin e tij në një nga IEVP-të.

Nga inspektimi u evidentua se, në ambientet e bllokut të sigurisë **nuk** ishin të afishuara posterat me kartën e të drejtave të personave të arrestuar/ndaluar, me pretendimin se janë duke përgatitur stenda të reja. Nga intervistimi i punonjësve të policisë që krenë shërbim në ambientin e shoqërimit, u evidentua gjithashtu se, letra me të drejtat e personave të privuar nga liria, **nuk** u jepet shtetasve që në momentin e parë të hyrjes në mjediset e policisë. Dhënia e letrës me të drejtat e personave të privuar nga liria në mjediset e policisë së shtetit, si dhe afishimi i posterave në ambiente të aksesueshme nga të shoqëruarit, të arrestuarit dhe të ndaluarit, janë një garanci për informimin e këtyre personave për të drejtat e tyre, pavarësisht qëllimit të shoqërimit apo veprës penale të kryer prej tyre.

Avokati i Popullit shpreh shqetësim të thellë për mungesën e këtyre elementëve minimal formal në lidhje me garantimin e të drejtave të personave të arrestuar.

Lidhur me këtë konstatim, më parë është shprehur me rekomandim edhe KPT (CPT) në përfundim të vizitës inspektuese në Shqipëri në vitin 2018, ku thuhet specifikisht se: *“Sigurohuni që personat e arrestuar/arrestuar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë në fillim të ndalimit ose arrestimit. Personave të arrestuar/ndaluar duhet t'u jepet dhe të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se kanë marrë një kopje të fletës me të drejtat e tyre.”*¹²

Në kuadër të të drejtës për informim, **punonjësi i policisë ka për detyrë ti njoh personat e shoqëruar me kartën e të drejtave që ju njeh ligji**, e cila parashikon të drejtën për të kërkuar avokat mbrojtës (nëse e dëshiron), e drejta për të njoftuar familjarët e tij lidhur me faktin e shoqërimit dhe të vendndodhjes, si dhe për të kërkuar shërbim shëndetësor (nëse është e nevojshme prej tyre).

Në “Bllokun e Sigurisë” u konstatua gjithashtu se, mungonte lista e përditësuar e avokatëve kryesisht, të miratuar nga organi i prokurorisë, me qëllim që në rastet kur personi i arrestuar/ndaluar nuk ka mundësi financiare për sigurimin e avokatit mbrojtës, njoftohen avokatë nga lista që duhet të jetë e afishuar në ambientin e sigurisë.

Në DVP Tiranë, pavarësisht se “Blloku i Sigurisë” është i ndërtuar sipas normave dhe parametrave që duhet të plotësojë ambienti i sigurisë, konstatohet se nuk ka qenë në projekt dhe aktualisht mungon ambienti i ajrimit¹³, i cili shërben për nxjerrjen në ajrim të të arrestuarve/ndaluarve sipas orarit të veprimeve. Ky ambient, mund të shërbejë njëkohësisht edhe për konsumimin e duhanit për ata persona që e pijnë atë dhe të ndalohet kategorikisht konsumi i duhanit brenda në dhomat e sigurisë, pasi përbën rrezik për cënimin e jetës të personave me problem të rënda të shëndetit mendor e psikologjik, si dhe dëmton shëndetin e personave të tjerë.

Nga informacioni i drejtuesve të policisë, por edhe nga intervistat e zhvilluara me personat e arrestuar/ndaluar, rezultoi se në dhomat e sigurisë personat trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë, sipas normativave të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej dhe servirej me shërbim “katering”, nga një subjekt privat me të cilin ishte lidhur kontratë me DVP Tiranë.

¹² shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 10-11.

¹³ Kreu VII, pika 6 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambient kulturi, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Ambientet e intervistimit

Në dhomat e reja të shoqërimit në DVP Tiranë, pavarësisht ambienteve të lira ende **nuk** ishte krijuar një dhomë më vehte për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një veprë penale. Në mungesë të kësaj dhome, personat e shoqëruar vijnë të merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Kjo praktikë duhet të ndryshojë menjëherë dhe duhet të zbatohet pa vonesë standardi ligjor.

Në “Bllokun e Sigurisë”, sikurse e theksuam më lart, ishin krijuar dhoma për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar në secilin kat, të cilat ishin të pajisura me orënditë e nevojshme të punës (tavolinë dhe karrige të montuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme), si dhe me sistemin e kamerave audio-vizive.

Avokati i Popullit e konsideron krijimin e dhomave për marrjen në pyetje dhe procesin e intervistimit të personit, në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, të cilat të jenë të monitoruara me sistemin e kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Grupi i monitorimit, inspektoi zyrat e punës të punonjësve të policisë që kryenin veprime procedurale me personat e shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar. Nga monitorimi, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj personave me të cilët ata kryenin veprime procedural, por nuk ka pak raste të denoncimeve publike nga shtetas të privuar nga liria, që janë ankuar për ushtrim të presionit psikologjik nga punonjës policie, ndonëse të papasqyruara në regjistërin përkatës.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Grupi i inspektimit të MKPT-së, konstatoi se në ambientet e “Bllokut të Sigurisë” dhe ambientet e shoqërimit të DVP-së Tiranë, **nuk** ishin të afishuara në vende të aksesueshme posterat me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Por, gjatë intervistave të zhvilluara me personat që ndodheshin në mjediset e privimit të lirisë të

kësaj drejtorie, përgjithësisht ata pohonin se ishin njohur me të drejtat e tyre ligjore nga punonjësit e policisë kur ishin marrë në pyetje.

Në dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale në nenet 34/a, gërma “c” dhe 34/b gërma “a”, si dhe ligji “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar, në pikën 3 të nenit 109, përcaktohet se, çdo shtetas në momentin e privimit të lirisë në mjediset e policisë së shtetit, ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin mbrojtës. Nga verifikimi i regjistrit për “takime me avokatin”, si dhe intervistat e zhvilluara me personat e ndaluar dhe të arrestuar, u konstatua se kjo e drejtë ishte respektuar, me përjashtim të dy të arrestuarve (midis tyre një grua) që deklarorin se, **nuk** kishin kontaktuar me avokatë mbrojtës në momentin e komunikimit të masës së sigurisë nga punonjësit e policisë.

Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, respektohej e drejta që personat e arrestuar/ndaluar që nuk kishin mundësi financiare për të patur avokat mbrojtës dhe kërkonin asistencë juridike, organi i prokurorisë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ju cakton atyre avokat mbrojtës nga lista e avokatëve të miratuar prej tyre.

Nga verifikimi i regjistrave ku evidentoheshin të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, por dhe intervistat me personat në dhomat e sigurisë u evidentua se, ishin njoftuar familjarët e tyre që në momentin e privimit të lirisë, të hyrjes në mjediset e shoqërimit në DVP Tiranë.

Grupi i inspektimit takoi dhe intervistoi të miturin në konflikt me ligjin, që ndodhej në bllokun e sigurisë, ku rezultoi se gëzonte të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, të drejtat e parashikuara në pikën 1, të Kreut IV të procedurës standarde, si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga punonjësit e policisë, personit të mitur i ishte ofruar ndihmë ligjore dhe psikologjike sipas legjislacionit përkatës, në prani të avokatit mbrojtës, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut të DVP-së Tiranë.

Për shtetasit e huaj të arrestuar/ndaluar, komunikimi me punonjësit e policisë dhe prokurorin bëhej në gjuhën amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë, nëpërmjet avokatit apo një përkthyesi. Arrestimi apo ndalimi i tyre kryhej sipas procedurave, duke njoftuar paraprakisht zyrat konsullore të shteteve respektive. Por, nga intervistat me 4 shtetasit e huaj që ndodheshin në bllokun e sigurisë, rezultoi se në momentin e marrjes në pyetje nga OPGJ e DVP Tiranë, ishin kryer në praninë e avokatit mbrojtës, por pa praninë e përkthyesit në gjuhën e tyre amtare. Sa më sipër, përbën shkelje flagrante të të drejtave të tyre.

Në kohën e inspektimit në ambientin e shoqërimit dhe bllokun e sigurisë u konstatua se, mungonte karta e të drejtave e përkthyer në gjuhët e huaja më kryesore, me qëllim informimin e këtyre shtetasve me të drejtat e tyre. Shtetasit e huaj, gëzojnë të njëjtat të

drejta që kanë edhe shtetasit shqiptarë. Në rastin kur privohet liria, për arsye të parashikuara në ligj, shtetasit kanë të drejtë të informohen mbi të drejtat dhe arsyet e shoqërimit/ndalimit/arrestimit, **që në momentin e parë të privimit të lirisë** sikurse parashikohet në ligjin “Për policinë e shtetit”, në nenin 109 pika 3 si dhe në nenin 34/a pika a K.Pr.P.

Dhomat e vizitave mjekësore, ishin të krijuara në secilin kat të bllokut të sigurisë. Vizitat kryheshin nga mjeku i DVP-së Tiranë, i cili ishte prezent në ambientet e sigurisë në momentin e inspektimit, duke kryer vizita mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe nga intervistat e zhvilluara me të arrestuarit/ndaluarit, rezultoi se vizita mjekësore nga mjeku i DVP Tiranë, ishte kryer brënda afatit 12 orë nga hyrja e tyre në dhomat e sigurisë¹⁴.

Vizitat mjekësore, rekomandimet për vizitë te mjeku specialist dhe dhënia e ilaçeve për të sëmurët kronikë, regjistroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i bllokut të sigurisë së DVP-së Tiranë.

Grupi i inspektimit kontrolloi regjistrin e kërkesë/ankesave që mbahej në ambientin e shoqërimit dhe në bllokun e sigurisë, por për periudhën e inspektimit nuk kishte regjistruar asnjë ankesë. Ndërsa, kërkesat e evidentuara kishin të bënin me kërkesa për avokat mbrojtës, për vizitë mjekësore nga mjeku, si dhe njoftimin e familjarëve.

Lidhur me mënyrën e evidentimit të kërkesë/ankesave të personave që shoqërohen, arrestohen apo ndalohen në mjediset e Policisë së Shtetit, institucioni i Avokatit të Popullit, ka rekomanduar që e drejta e paraqitjes së ankesës nga këta persona, duhet të jetë e pasqyruar edhe në kartën e të drejtave, me qëllim për të përmirësuar sistemin e trajtimit dhe zgjidhjes në kohë të tyre, nga strukturat përgjegjëse në organet e policisë.

Në DVP Tiranë u evidentua se, **nuk** zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit e çështjes përkatëse.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, si dhe nenit 81, pika 2/b të ligjit 81/2020

¹⁴Kreu II, pika 7/b e procedurave standarde: “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

ku përcaktohet se Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca: *“paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*:

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa të menjëhershme, për zbatimin e detyrimit ligjor nga punonjësit e policisë (OPGJ) në DVP Tiranë, të cilët në përfundim të veprimeve procedurale me personat e dyshuar për kryerjen e veprave penale, në momentin e komunikimit të masës së sigurisë “arrest me burg” dhe kalimin në bllokun e sigurisë, ti pajisin ata me procesverbalin e arrestimit në flagrancë apo urdhrin e ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore, prokurori, urdhri i ekzekutimit të prokurorit, si dhe kopje të vendimit gjyqësor; procesverbalin e kontrollit personal, si dhe letrën e të drejtave që gëzojnë personat e arrestuar apo të ndaluar.
Për punonjësit që kanë kryer shkeljet e mësipërme, të nisë procedura disiplinore për shkelje të procedurave ligjore gjatë kryerjes së detyrës.
2. Të merren masa të menjëhershme, për afishimin në ambientet e bllokut të sigurisë, të listës me avokatë mbrojtës të miratuar nga organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht, në rastin kur i arrestuari/ndaluari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatë mbrojtës.
3. Të merren masa të menjëhershme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe bllokun e sigurisë, të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo ndaluar në mjediset e policisë së shtetit.
4. Të merren masa të menjëhershme, për zbatimin e detyrimit ligjor, për plotësimin dhe dhënien e kopje të procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë.
5. Të merren masa të menjëhershme, për heqjen e skarrave të hekurit që ndodhen në korridorin e dhomave të shoqërimit, si dhe në disa nga ish-dhomat e sigurisë në DVP Tiranë.
6. Të merren masa të menjëhershme, për trajnimin e stafit të punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me të shoqëruarit/arrestuarit dhe të ndaluarit në DVP Tiranë, me qëllim informimin me arsyet e shoqërimit/arrestimit dhe të ndalimit dhe njohjen me të drejtat që gëzojnë personat kur shoqërohen në mjediset e policisë, që në momentin e privimit të lirisë, sipas rekomandimit edhe të KPT-së. Kanë nevojë të njihen të drejtat e të arrestuarve, si dhe për rolin e institucioneve monitoruese dhe mbikqyrëse.
7. Të merren masa të menjëhershme, për garantimin e të drejtave të shtetasve të huaj që ndodhen në mjediset e privimit të lirisë të policisë së shtetit, duke ju siguruar kartën e të drejtave të përkthyer në gjuhët e huaja, si dhe kryerjen e veprimeve procedurale në

prani të avokatit mbrojtës dhe të përkthyesit në gjuhën amtare apo të kuptueshme nga ana e tyre. Gjithashtu, të merren masa disiplinore për punonjësit që nuk kanë garantuar të drejtat e personave të huaj.

8. Të merren masat e nevojshme, për sigurimin e ujit të pijshëm për personat e arrestuar/ndaluar në “Blokun e Sigurisë”, duke instaluar në sistemin e brendshëm të furnizimit me ujë nga UKT, të filtrave që shërbejnë për pastrimin dhe rritjen e cilësisë së ujit, me qëllim të bëhet i përdorshëm nga personat që ju është privuar liria në këto mjedise.
9. Të merren masa të nevojshme, për krijimin në bllokun e sigurisë të një ambienti që të shërbejë si ambient ajrimi për personat e arrestuar/të ndaluar, si dhe ambient për pirjen e duhanit nga personat që e konsumojnë atë.
10. Të merren masat e nevojshme, për përshtatjen e adoptimin në ambiente shoqërimi të dhomës për intervistimin/marrjen në pyetje të të shoqëruarve, si dhe pajisjen e saj, sipas kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në procedurën standarde për këtë qëllim.
11. Të merren masat e nevojshme, nga sektori ekonomik në DVP Tiranë në lidhje me mirëmbajtjen e ambienteve të dhomave të sigurisë, pajisjeve elektrike dhe hidraulike të instaluar në “Blokun e Sigurisë, duke planifikuar fonde për mirëmbajtjen e këtij investimi.
12. Të krijohen dhomat e intervistimit në ambientin e shoqërimit dhe ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së parregullt e tashmë të pajustificuar, për marrjen në pyetje të personave në zyrat e OPGJ-ve dhe pa monitorim.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brënda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI